

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj,

Në zbatim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe shkencës, nënshkruar më 8.03.2010, hyrë në fuqi më datë 1.12.2011, miratuar me VKM Nr. 265 datë 21.04.2010, “Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunimin në fushat e arsimit dhe të shkencës”, Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare për Kërkim Shkencor dhe Inovacion (AKKSHI), çel raundin e parë të thirrjeve për aplikime të përbashkëta kërkimore, tekniko- shkencore, mes Shqipërisë dhe Kosovës.

Kjo thirrje do të jetë e hapur prej datës 15. 05. 2019 deri më 15. 08. 2019.

Kjo thirrje është e hapur në për të gjithë fushat e kërkimit shkencor dhe ndaj të gjithë kërkuesëve shkencor.

Të gjithë të interesuarit, janë të lutur të aplikojnë duke mbushur kërkesat dhe formularët e aplikimit, në dokumentacionin bashkëlidhur kësaj thirrje.

Dokumentat do të dorëzohen në versionin *hard- copy*, pranë Agjencia Kombëtare për Kërkim Shkencor dhe Inovacion (**AKKSHI**), brenda afatit të parashikuar në këtë thirrje (15. 05. 2019 deri më 15. 08. 2019).

Projekt- propozimet fituese, do të financohen për një afat kohor prej 2- vitesh, me grante të ndara për secilin vitit, të cilat do të jepen sipas kërkesës dhe në përputhje me tabelen financiare bashkelidhur në projekt- propozim.

Shuma e grantit për secilin vit, nuk do të jetë më lartë se 3000 EUR, te cilat do të konvertohen në ALL me kursin e këmbimit të datës në të cilën do të bëhet aplikimi.

Projekt- propozimi, do të përpilohet në shqip dhe në anglisht dhe do të dorëzohet njëkohësisht nga partnerët e projektit në agjencitë dhe shtetet përkatëse.

Në Shqipëri projekt- propozimi, do të dorëzohet në 3- kopje për secilën gjuhë dhe do të jetë i shoqëruar nga *Letra Përcjellëse*, e cila firmoset nga titullari i institucionit kërkimor. (Lutem referohuni ligjit si më lart shënohet).

Projekt- propozimet do të shqyrtohen dhe me tej vlerësohen, sipas sistemeve të miratuara të vlerësimit në secilin shtet, ndërsa fituesi do të shpallet pas krahasimit të vlerësimeve në të dy shtetet.

Gjithë të mirat!